



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.758/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, e përbërë nga gjyqtari individual Naim Mehulli, në çështjen juridike të paditësit B. K. e S. me seli në P. Rr. F. G. nr.6, kundër të paditurit A. S. nga Fsh. K. K. e M. baza e kontestit Rimbursim dëmi, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 22.02.2017, me datë 09.03.2017 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. OBLIGOHET** i padituri A. S. nga Fsh. K. K. e M. që brenda afatit 7 ditorë t'ia paguaj paditëses në emër të rimbursimit të dëmit shumë prej 154.00 €, me kamat sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

- II. OBLIGOHET** i padituri që në emër të taksës gjyqësore për padi t'ia paguaj paditëses shumë prej 15 €, si dhe në emër të taksës gjyqësore për përpilimin e aktgjykimit t'ia paguaj gjykatës shumë prej 15 €, në afat 7 ditorë, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja ka ngritur padi në gjykatë me date 31.12.2015, me anë të së cilës ka kërkuar që në emër të rimbursimit të dëmit, I padituri t'ia kompensoj shumë prej 154.00 € të shkaktuar në aksidentin e datës 31.07.2011.

E autorizuar e paditëses në seancë e shqyrtimit kryesor të datës 22.02.2017 ka propozuar që të mbahet seanca gjyqësore në mungesë të të paditurit pasi që I padituri nuk ka qenë prezent edhe pse është ftuar në rregull e mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata e ka aprovuar propozimin e paditëses që seanca të mbahet në mungesë të të paditurit i cili është ftuar me rregull. Përfaqësuesja e paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar fillimisht dua ta sqaroj faktin se në padi është lëshuar një gabim teknik ku emir I të paditurit është shkruar A.

ndërsa duhet të jete A. gjithashtu mbesim në tersi pranë padis dhe kërkesëpadisë dhe baza juridike e padis nuk është kontestuese ku kjo vërtetohet nga deklarata e të paditurit e dt:31.07.2011, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj padinë, ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se nga provat e administruara u vërtetua baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, kjo në veçanti është vërtetuar nga raporti i policisë ku i padituri e pranon fajësinë. Padiësja e ka kompensuar palën e dëmtuar në lartësi prej 154.00€ andaj I propozoj gjykatës që ta aprovoj në tersi si të bazuar padinë, si dhe shpenzimet e procedurës i kërkojmë në shumë prej 15 € me kamat ligjore.

Gjykata në shqyrtimin kryesor i administroj këto prova: Lexohet transferi i lëshuar nga BKS drejtuar B. E. me date 17.09.2012, urdhërtransferi i datës 03.09.2012, ujdia jashtëgjyqësore e datës 30.08.2012, vendimi i BKS-së i datës 27.08.2012, vendimi i Komisionit të shkalles së pare të trajtimit të dëmit nga BSK-ja i datës 27.08.2012, profaktura me nr., aktvlersimi i dëmit nga BSK-ja i datës 27.08.2012, kërkesa për rimbursim nga KS S. i datës 22.08.2012, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit nga KS S. i datës 19.09.2011, urdhërpagesa me nr te faturës e datës 23.11.2011, katër fotografi nga vendi i aksidentit, fotokopja e letërnjoftimit për policin H. T., F. operative e Policisë së Kosovës e datës 20.09.2011, fatura e lëshuar nga Reforma, raporti policor lidhur me aksidentin e trafikut të automjetit policie-034-04 i datës 31.08.2011, raporti i aksidentit të komunikacionit- Njësia e Trafikut Rajonal i datës 03.08.2011, kërkesa për fillimin e procedurës për Kundërvajtje i datës 31.07.2011, deklarata e dëshmitarit –këtu të paditurit e datës 01.08.2011, kopja e patentë shoferit së bashku me letërnjoftimin për të paditurin , raporti i policisë i datës 31.07.2011.

Pas shiqimit dhe analizimit te prova një nga një dhe të gjitha së bashku ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 të LPK-së, gjykata vlerësoj se në mes palëve ndërgjyqëse nuk janë kontestuese këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë pjesëmarrës dhe shkaktar I aksidentit të datës me automjetin IMT T. pa targa të regjistrimit, i cili ka qenë i pasiguruar gjeqësisht sigurimi i ka skaduar, në të cilin aksident i padituri e ka goditur automjetin K. S. me targa pronë e Policisë së Kosovës, duke i shkaktuar dëme material, kjo vërtetohet me raportin e aksidentit me nr. i dt: , si dhe nga skica e aksidentit, nga aktvlersimi i demit i datës, nga procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i datës 19.09.2011 si dhe nga deklarata e të paditurit te dhanë në polici me date.

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se KS e ka kompensuar personin e tretë P.K. pasi që ka poseduar polis të sigurimeve KASKO, ku e njëjta e ka fituar të drejtën e regresit dhe ka parashtruar pranë padiësës kërkesën për kompensim dëmi me datë.

Nuk është kontestuese fakti se paditësja ka lidhur ujdi jashtgjqësore me date me K.S. të cilin me autorizim e ka përfaqësuar drejtori i përgjithshëm Rr.P. për kompensim të dëmit në shumë prej 154.00 €.

Se automjeti i të paditurit ka qenë i pasiguruar në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk është kontestuese dhe kjo vërtetohet nga raporti i policisë i datës.

Se personi i tretë P. K. e dëmtuar në këtë aksident është kompensuar në emër të shkaktimit të dëmit nga ana e paditëses, kjo vërtetohet në bazë të urdhrit të transferit të datës.

Gjithashtu, nuk është kontestues fakti se personi i tretë ka qenë i dëmtuar, pasi që kjo vërtetohet me raportin e aksidentit i dt: me nr. si dhe nga skica e aksidentit.

Sa i përket të drejtes materiale, gjykata u bazua në nenin 18 par 1 e 4 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësija, pasi që i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit ka drejtuar automjetin e pa siguruar, ndërsa dëmin e shkaktuar e ka mbuluar B. K. e S. e cila e ka të drejtën e regresit.

Gjykata, lidhur me shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 452 të LPK-së(Ligjit të Procedurës Kontestimore), ku parashihet se pala e cila humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqfituse t'i shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore, ndërsa për shpenzime gjyqësore u bazua në nenin 10. Pika 12 në lidhje me pikën 1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për unifikimin e taksave Gjyqësore nr.2008/2.

Andaj nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 143 par 3 të LPK-së(Ligjit të Procedurës Kontestimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.758/2015. dt.09.03.2017

GJYQTARI
Naim Mehulli

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.